Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
Njësia Org. / Org. Jedinica / Org. Unit: 03/PERS
Nr. Prot. / Broj Prot. / Prot. No: 1725
Nr. i faqeve / Broj stranica / No. pages: 2
Data / Datum / Date: 11/11/2016

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Ligji Nr. 03/ L -149, Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë bën :

# REKRUTIM

**Institucioni:** Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
**Departamenti:** Financave dhe Shërbimeve të përgjithshme

**Titulli i vendit të punës:** **Zyrtar për administrimin e teknologjisë informative**
**Koeficienti / 7**
**Nr. i Referencës: MTI/26**
**Vendi: Prishtinë**

**Datë: 11.11.2016**

---

## Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Mirëmbajtja e harduereve dhe softuereve në sistemin e MTI-së;
- Mirëmban rrjetin e brendshëm të MTI-së;
- Kontrollon aspektet e sigurisë së sistemit TI dhe identifikon nevojat e tanishme dhe të ardhshme për TI, duke bashkëpunuar me strukturat e të gjitha niveleve;
- Menaxhon me Active Directory ( users and copmuters) në bashkëpunim me ASHI- në;
- Menaxhon me File Server të MTI-së;
- Planifikon, menaxhon dhe mirëmban aplikacionet tjera që operojnë kryesisht në familjen e Windows server si dhe kryen dokumentacionet përkatëse;
- Rregullisht kontribuon në zhvillimin e koncepteve të reja, teknikave dhe standardeve;
- Përgjigjet në të gjitha kërkesat e stafit të MTI-së që kanë të bëjnë me fushën e IT-së;
- Kryen edhe detyra tjera që kërkohen nga mbikëqyrësi.

## Kualifikimet për këtë vend të punës:

- Diplomë Universiteti: Shkenca kompjuterike;
- Certifikata për trajnime profesionale në lëmin e IT-së ( e domosdoshme);
- 2 vite përvojë pune në lëmi të ngjajshme;
- Njohuri për programe kompjuterike dhe njohuri për server ( e domosdoshme);
- Njohja e gjuhës angleze ( përparësi);
- Aftësi për rrjedhat e punës dhe procedurat;
- Aftësi për punë nën presion dhe fleksibilitet në punë

**Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e republikës së Kosovës, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e lartë dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

**Kohëzgjatja e emërimit:**

Nëpunësi i karrierës (përhershëm) Periudha provuese .Dymbëdhjetë (12) muaj.

**Data e mbylljes së konkursit:**

**25.11.2016**

**Paraqitja e kërkesave**

Formularët për aplikim mund të merren në recepcion të MTI-së, ose të tërhiqen nga *web* faqja e MTI-së, ku është bërë edhe shpallja e konkursit , në adresën **www.mti-ks.org** dhe dorëzohen në Divizionin e Burimeve Njerëzore, çdo ditë pune nga ora 8:00 -16:00 deri më**: 25.11.2016.** Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr. tel. 038-200 36-578.

*"Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë".*

*"Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcionalë organet e shërbimit civil të administratës publike,qendrore dhe lokale,siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3të Ligjit Nr..03/L-149 mbi shërbimin Civil të Republikës së Kosovës"*

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuara,vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.